

L I G J
Nr.8173, datë 21.12.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8076, DATË 22.2.1996 “PËR BANKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Buxhetit, Financave dhe Privatizimit,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8076, datë 22.2.1996 “Për Bankën e Shqipërisë” në nenin 42, pika 1, bëhen këto ndryshime:

- Fjalët “zëvendësgovernatori i parë” zëvendësohen me fjalën “zëvendësgovernatori”
- Fjala “zëvendësgovernatori” zëvendësohet me fjalët “sekretari i përgjithshëm”.

Neni 2

Në të gjitha nenet e ligjit të mësipërm në të cilat ekzistojnë fjalët “zëvendësgovernatori i parë” dhe “zëvendësgovernatori” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “zëvendësgovernatori” dhe “sekretari i përgjithshëm”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1689, datë 30.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha